

Ekskluzive

Ekskluzive | U ndal në pikë kontrolli në Isniq – Policia i gjen pistoletë, thikë dhe 50 fishekë 24-vjeçarit



Sinjali.com

03 Gusht 2026 10:19



Një kontroll rutinë i Policisë në fshatin Isniq të Deçanit ka çuar në sekuestrimin e një arme, një thike dhe dhjetëra fishekëve, ndërsa një 24-vjeçar është arrestuar nën dyshimin për armëmbajtje pa autorizim.

Sinjali mëson se i dyshuari është **Blendon Dautaj**, 24 vjeçar

Sipas burimeve, ngjarja ka ndodhur paraditen e 2 gushtit, rreth orës 09:40, kur patrulla e Stacionit Policor në Deçan, gjatë një pike kontrolli në fshatin Isniq, ka ndaluar një veturë Mazda me ngjyrë hiri.

Gjatë kontrollit të automjetit, zyrtarët policorë kanë vërejtur se në prehrin e të dyshuarit ndodhej një pistoletë me gaz, të cilën dyshohet se e posedonte në mënyrë të kundërligjshme. Po ashtu, gjatë kontrollit janë gjetur edhe një brisk dhe një pako me 50 fishekë të kalibrit 9 mm.

Në vendin e ngjarjes kanë dalë hetuesit policorë dhe njësia e krimteknikës, të cilët kanë sekuestruar armën, municionin dhe mjetin e mprehtë në cilësinë e provave materiale.

I dyshuari është arrestuar dhe është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës, ndërsa është intervistuar edhe një dëshmitar lidhur me rrethanat e rastit.

Me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj Blendon Dautajt është iniciuar procedurë për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa pas intervistimit ai është liruar në procedurë të rregullt.

Rasti mbetet nën hetime.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera